

# **Manifesti (Deklarata) për cilësinë e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare**

## **15 parimet për njohjen e kontributit të veçantë të lëndës së historisë në zhvillimin e të rinjëve**

Parandalimi i keqpërdorimeve të së kaluarës  
*Kompleksiteti - Multiperspektiviteti - Mendimi kritik*

### **Parimi 1**

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare nuk nënkupton orvatjen që të transmetohet një e vërtetë e vetme për të kaluarën.** Por, ka për synim që të vërtetës historike t'i qaset sa më afër që është e mundur, bazuar në fakte solide dhe dëshmi të përshtatshme dhe përpjekje në drejtim të objektivitetit. Ajo krijon të kuptuarit që rrëfimet historike janë shumështrësore dhe të komentueshme, nxit gatishmërinë për të vënë në dyshim këto rrëfime si dhe nxit të menduarit kritik.

### **Parimi 2**

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare zbërthen mitet dhe stereotipet historike** duke vendosur “pasqyrën e krenarisë dhe dhimbjes” tradicionale në perspektivë, në këtë mënyrë i mbështet mësimdhënësit dhe nxënësit që të vënë në pyetje logjikën dhe idiomat kulturore të tyre. Ky model tradicional u krijua rreth vuajtjes së kombit në një anë dhe krenarisë kombëtare në anën tjetër, duke shpërfill të treguarit për dëmin e bërë ndaj të tjerëve dhe historitë e atyre rajoneve që nuk lidhen me rrëfimet kombëtare.

### **Parimi 3**

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare rritë vetëdijesimin për faktin që e kaluara përceptohet/kuptohet në mënyra të ndryshme** duke u bazuar në mjedisin social, seksual dhe gjeneratën e individit, po ashtu përkatësinë etnike, gjuhësor dhe religjioz të komunitetit dhe botë-vështrimet e ndryshme në shoqëri. Kjo nxit të pranohet që njerëzit dhe ngjarjet duhet të vlerësohen në kontekst të kohës dhe vlerave të tyre.

### **Parimi 4**

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare i adreson temat e ndjeshme dhe të diskutueshme në histori në mënyrë të përgjegjshme** që ta minimizoj ndikimin e pikëpamjeve të njëanshme, të anëshme dhe politike të të kaluarës dhe t'i sjell ato në natyrën e tyre komplekse dhe multidimensional. Kjo nënkupton shmangien e gjuhës emocionale, subjektive dhe armiqësore dhe promovon përdorimin e koncepteve të paanëshme, veçse pa pastrimin dhe zbardhimin e rrëfimeve historike problematike, për të marrë një pikturë rozë të së kaluarës.

## Parimi 5

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare** promovon pajtimin afatgjatë tek shoqëritë e ndara duke zhvilluar shkathtësitë e bashkëndjeshmërisë dhe mundësinë e mospajtitimit për interpretimet e të kaluarës pa përdorimin e urrejtjes dhe dhunës.

### Promovimi i gjasjes gjithëpërfshirëse në studimin e së kaluarës

*Diversiteti - Dialogu – Barazia*

## Parimi 6

**Cilësi e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare do të thotë që të pranohet se rëndësia e saj është e lidhur me eksperiencën dhe sfidat aktuale** dhe prandaj, përmes saj synohet që të ndihmohen nxënësit të kuptojnë botën ku jetojnë dhe të përkrahet orientimi i tyre për të ardhmen. Kjo në veçanti nënkupton bindjen në atë që studimi i së kaluarës është instrument (mjet) në zhvillimin e vetëdijes politike dhe qytetare, si rrjedhim i ndërlidhjes së historisë dhe qytetarisë si dy lëndë shkollore të rëndësishme të përbashkët.

## Parimi 7

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare nënkupton prezantimin e perspektivave globale dhe përfshirjen e dimensioneve të shumëfishta të studimit të së kaluarës – politike, shoqërore, ekonomike, kulturore dhe mjedisore.** Kjo përfshinë studimin e ngjarjeve kyçe ( kryesore ) por gjithashtu edhe zhvillimet afatëgjate dhe adresimin e temave madhore siç janë jeta e përditshme, natyra, gjinia, të drejtat njeriut dhe migrimi.

## Parimi 8

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare** nënkupton adresimin e një shumëllojshmëri të vlerave njerëzore, besimeve, qëndrimeve dhe prirjeve, siç janë demokracia, toleranca, respekti për të drejtat e njeriut, mirëkuptimi i ndërsjellë, kohezioni shoqëror, solidariteti, liria, guximi, mundësitë e barabarta dhe përgjegjësitë, por gjithashtu edhe dashuria dhe miqësia. Por, gjithashtu nënkupton trajtimin e koncepteve negative të tilla si stereotipet, paragjykimet, njëanshmëria, ksenofobia, racizmi, dhuna dhe urrejtja, sepse edhe ato janë pjesë e spektrit të sjelljeve njerëzore dhe kanë nevojë për reflektim mbi to.

## Parimi 9

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare** nënkupton të përqafuarit e diversitetit kulturorë, religjioz dhe gjuhësorë si një mënyrë për të nxitur kohezionin shoqëror dhe gjithëpërfshirjen, dhe kontributin në dialogun ndërkulturorë e ndërfetarë.

## Parimi 10

Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare nënkupton përdorimin e “ historisë rreth nesh “ si mënyrë e fuqishme në përcjelljen e mirëkuptimit të “ gjallë” të së kaluarës, dhe përqafimin e trashëgimisë si një qasje unike në këtë të kaluar përmes trashëgimisë së prekshme dhe të paprekshme.

### Avancimi i mëimit inovativ

*Angazhimi – Kompetencat – Autonomia*

## Parimi 11

Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare është e bazuar në **kompetenca**, duke përfshirë komponenten kognitive (njohurinë), funksionale (aplikimin e njohurisë), personale (sjelljen) dhe etike (parimet që udhëzojnë sjelljen). Kjo nënkupton dhënien e rëndësisë së barabar të përvetësimit nga konteksti i përshtatshëm i dijes (njohurisë), shkathtësive dhe sjelljeve, besimeve, dispozitave dhe vlerave.

## Parimi 12

Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare kontribuon në zhvillimin e **kompetencave kyqe (kryesore)**<sup>1</sup> siç janë kompetenca shoqërore dhe qytetare, e vetëdijësimit kulturor dhe shprehjes, e të mësuarit si të mësojmë, kompetenca digjitale, ndjesia e iniciativës dhe ndërmarrësisë. Gjithashtu në kompetenca të tërthorta siç janë mendimi kritik, kreativiteti, zgjidhja e problemit dhe vendimmarrja.

## Parimi 13

Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare zhvillon **shkathësitë fundamentale të të menduarit dhe koncepteve**: të kuptuarit kronologjik, domethënia historike, dëshmia e burimit parësor, interpretimi, shkaku dhe pasojat, ndryshimi dhe vazhdimësia, krahasimi dhe dallimi, bashkëndjenja, fakti dhe opinion (mendimi), paragjykimi dhe objektiviteti. Gjithashtu adreson konceptet e pavarura siç janë skllavëria, kushtetuta, socializmi ose depresioni.

## Parimi 14

Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare zhvillon **aftësinë e të kuptuarit dhe analizimit të çështjeve dhe ngjarjeve**; aftësia për mbledhjen, organizimin, hulumtimin dhe vlerësimin e burimeve në mënyrë logjike dhe koherente, duke shpjer drejt përfundimeve dhe

<sup>1</sup> Përcaktuar në Kornizën Referuese Evropiane të vitit 2006

[http://ec.europa.eu/dgs/education\\_culture/publ/pdf/ll-learning/keycomp\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/dgs/education_culture/publ/pdf/ll-learning/keycomp_en.pdf)

gjenerimit të ideve. Gjithashtu ndihmon në mësimin e talenteve për shprehjen e qartë duke shtyer përpara idetë dhe argumentet në mënyrë koncize.

## **Parimi 15**

**Cilësia e lartë në mësimin e historisë, trashëgimisë dhe edukatës qytetare përfshinë strategjitë pedagogjike dhe të vlerësimit, që zgjerojnë mësimin e pavarur, motivimin dhe angazhimin,** nxit ndjenjën e përgjegjësisë, pasionin për përfshirje aktive, një thirrje për të marrë iniciativë dhe stimulon komunikimin dhe bashkëpunimin. Thekson zhvillimin e kureshtjes, autonomisë, mendjes së hapur dhe globale, një shpirti kërkues dhe aftësinë e të menduarit të pavarur dhe rezistimin ndaj manipulimit.